
Barazia midis grave dhe burrave në Gjermani

Barazia mes njerëzve me orientime të ndryshme seksuale dhe identitet të ndryshëm gjinor në Gjermani.

Në gjermani ndalohet diskriminimi apo dhuna për shkak të gjinisë, ngjyrës së lëkurës, fesë apo identitetit seksual, dhe mund të ndiqet penalisht. Nëse dikush diskriminohet apo ndjehet i/e kërcënuar në ose jashtë strehimit, për shembull tek autoritetet ose gjatë bërjes së pazarit, për shkak të gjinisë, ngjyrës së lëkurës, fesë apo identitetit seksual, është e rekomandueshme të kontaktohet menjëherë një punonjëse ose punonjës i strukturës, t'ri drejtoheni policisë (numri i telefonit: 110,) ose të vizitoni një qendër përkatëse këshillimi (shih të dhënat e kontaktit më poshtë). Në Gjermani ndalohet dhe dënohet dhuna e çdo lloji, këtu përfshihen dhe ngacmimi, ngacmimi seksual ose qoftë dhe kërcënimi për dhunë ndaj personave të tjerë.

Burrat dhe gratë kanë të drejta të njëjta. Nuk lejohet ngacmimi i personave, qofshin këta meshkuj apo femra. Nëse dikush lutet të lihet i qetë, kjo duhet të pranohet. Akte seksuale kundër dëshirës së një personi janë të ndaluara dhe ndiqen penalisht.

Lesbiket, homoseksualët dhe njerëzit transeksualë kanë të drejta lirie të njëjta si të gjithë njerëzit. Partneritete të të njëjtit seks njihen me ligj në Gjermani dhe mund të lidhen njësoj në martesë zyrtare. Fatkeqësisht ka akoma njerëz që diskriminojnë të tjerët për shkak të orientimit seksual apo identitetit gjinor. Por homofobia dhe transfobia janë të pa dëshirueshme nga shoqëria.

Përndjekja në vendin e origjinës për shkak të identitetit seksual, për shembull me anë të ndalimit të homoseksualitetit, mund të jetë një arsye për azil në Gjermani. E njëjta gjë vlen edhe për përndjekjen e personave

Qendra të këshillimit dhe informacione të mëtejshme

Telefoni i ndihmës „Dhuna ndaj grave“ i zyrës federale për familje dhe detyra qytetare është anonim dhe në dispozicion gjatë gjithë kohës në numrin 08000 116 016 si dhe përmes këshillimit online në www.hilfetelefon.de Gjithashtu mund të mundësohen përkthyes dhe përkthyes për 15 gjuhë. E njëjta gjë vlen dhe për telefonin i ndihmës „Shtatzëna në nevojë“ që mund të arrihet në numrin 0800 40 40 020 dhe online në www.schwanger-und-viele-fragen.de.

transeksualë. Është e rëndësishme që gjatë procedurës së azilit, personi të këshillohet sa më herët dhe me informata të sakta rreth të drejtave të tij/saj. Zyrat këshilluese për lesbiket, homoseksualët dhe njerëzit transeksualë janë shpesh një mbështetje e rëndësishme (shiko të dhënat e kontaktit më poshtë).

Të drejtat themelore në kushtetutë garantojnë që secili dhe secila në Gjermani mund ta zgjedhë vetë partnerin ose partneren dhe të vendosë lirisht nëse do të martohet me këtë person ose të jetojë në një partneritet. Shumë çifte jetojnë bashkë të pamartuara. Disa njerëz preferojnë të jetojnë vetëm. Të qenit i/e pamartuar është njësoj normale si të qenit i/e martuar. Gjithashtu është e mundur që çiftet të vendosin të mos bëjnë fëmijë.

Shprehje publike të dashurisë mes çifteve, nuk janë të pazakonshme në Gjermani. Këto mund të jenë për shembull kapja për dore, përqaqimi dhe puthja. Kjo pranohet dhe është aq e vetëkuptueshme sa njerëzit e tjerë pothuajse nuk e venë re. Çiftet e gjinisë së njëjte kanë të njëjtat të drejta për të shprehur hapur dashurinë si çiftet e gjinive të ndryshme.

Punonjëset dhe punonjësit e këtij objekti janë në dispozicion për pyetje në lidhje me variantet e mësipërme. Ne nuk tolerojmë dhunën dhe diskriminimin në objektin tonë. Ju mund të na kontaktoni në çdo kohë nëse kanë ndodhur incidente të tilla ose nëse ndjeheni të kërcënuar. Punonjëset dhe punonjësit janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë dhe të respektojnë privatësinë.

Qendrat e këshillimit për lesbiket, homoseksualë dhe persona transeksualë gjinorë mund të gjenden në broshurën „Udhëzime për kujdesin dhe mbështetjen e refugjatëve LSBTTI*“.

Për temat e mësipërme mund të gjeni informacione në gjuhë të ndryshme edhe tek www.refugeeguide.de www.queer-refugees.de

